

QIRIAKO DEÇKA



epope  
në kodrën  
e kuqe

BIBLIOTEKA

854-32

Q 31

ESH-32

Q 31

QIRJAKO DEÇKA

E P O P E  
NË KODRËN E KUÇE

~~46328~~

LIBRARIJA E SHTETIT  
DURRES

703

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»  
TIRANË, 1968

«Trim ishte Vojo Kushi, trim i madh dhe rrallë linden të tillë burra. Vetëm tre ishin dhe nga këta të tre vetëm Vojo Kushi ishte i shëndoshë. Shoku i tij Sadik Stavaleci ishte tuberkuloz, Xhorxhi Martini e kishte trupin me plagë, po që të tre zemrat i kishin si çelik. Këta të tre luftuan gjashtë orë kundër qindra armiqve, kundër tankseve dhe mitra-lozëve. A e dini se ç'bëri Voja kur ju mbaruan fishekët dhe bombat? Ai, me gjoks përpara, sulmoi mbi tanks...

ENVER HOXHA

## LIRIA I KA RRËNJËT NË GJAK

Revolucioni i ngjan furtunës, merr hov nga gjokset punëtores, i rrëzon muret e vjetra, ku rri këmbëkryq padrejtësia e varfëria, i thyen lisat e harbuar dhe çliron mijëra fidanë e këta hedhin shtat e kapin rrezet jetëdhënëse të diellit... Si ajo kllçoça që mbledh zogjtë nëpër shkurre e driza, revolucioni i grumbullon bijtë e vet, u vë krahë e i bën shqiponja. Ushtarët e tij i dhurojnë gjak lirisë në fusha, në male e kodra, në fshat e në qytet. Kështu e ka revolucioni, ndoshta që bijtë e tij të mbeten të pavdekshëm, si lisat majë kreshtës.

Midis nesh nuk i shohim më të gjithë ata me të cilët, kokë më kokë, pranë dritës së zbetë të kandilit, në shtëpitë e vogla të qytetit tonë, lexonim traktin e parë të Partisë së Komunistëve Shqiptarë, lexonim fashikullin e parë të historisë mbi jetën e Leninit; nuk i shohim ata me të cilët ndamë pushkët me gjalmë e fishekët e ndryshkur, që në agimin e ardhshëm t'u bënim pritë shkelësve të trojeve tona, nuk i shohim më ata që vunë gurët e parë në themelet e kalasë sonë njëzetekatërvjeçare... Po ata rrojnë në zemrat tona, ranë që të mbeten të pavdekshëm... Me gjoksin e

tyre ndërtuan piedestalin, mbi të cilin ngrihet monumenti i madh i lirisë, me gjakun e zembrës së tyre gatuan llaçin e kuq të këtij piedestali dhe, ndoshta, në çastin e fundit, kur plumbat u merrnin jetën, ata thanë: «Edhe njëmijë jetë të kishim, përsëri kështu do t'i jepnim, në ballin e luftës, që të rrosh ti, partia jonë, ti, populli ynë!»

Ne i patëm pranë ata, i dëgjua m si flisnin me zjarr për mëmëdhenë, i morëm në krahë, u lidhëm plagët me mëngët e këmishëve, i mbështollëm me flamurin e kuq dhe, në netët e ftohta të dimrit, duke gërmuar mbi akull, i mbuluam me baltën e tokës mëmë, që aq fort e deshën. Ne u jemi borxhlinj atyre dhe veprën që bënë për këto troje, duhet ta lëmë të vizatuar, qoftë edhe thjesht, për niprit e stërniprit, se vepra e tyre do të jetë pasuria shpirtërore, forca dhe zemra për brezat që vijnë.

Dhe ja, morëm bojën e letrën për të derdhur kujtimet tona për ata që i patëm në krah në ditët e egra e me stuhi, për ushtarët e revolucionit tonë, për ushtarët me yje në ballë. Brezi ynë mbajti mbi supë Shqipërinë, atëhere kur në gjoksin e saj ishin ngulur thikat e fashizmit. Janë shumë ata që ranë dhe, ndoshta, s'do të ketë mundësi të flitet për të gjithë me hollësi. Po fytyrën e tyre, jetën e tyre, mund ta shohim te ata për të cilët do të flitet: ata kanë të gjithë një emër, sepse një ishte edhe ajo që i bashkonte: ideali i madh, komunizmi, për të cilin dhanë jetën.

Menduam shumë si t'ja fillojmë. Secili nga heronjtë tanë ka një jetë të pasur me ngjarje, por-sc, midis karvanit të yjeve partizane, në mendjen

tonë zgjodhëm atë të Vojo Kushit. E njohëm në punë, në jetë, në luftë; dhe e deshëm fort. Krenaria e tij buronte nga thjeshtësia; guximi, nga qëllimi i tij i madh e fisnik; forca, nga mëma që e pranoi për bir, partia, për të cilën dha jetën mbi tankun e armikut.

Do të ikin vite, shekuj dhe, ndoshta, brezave që do të vinë do t'u duket legjendë heroizmi i Vojo Kushit. Po ja që pati ditë të tilla që, mbi këtë tokë u desh gjak heronjsh legjendarë... Pra, le ta tregojmë trimërinë e heroit tonë.

\*\*\*

Kur dielli merrte udhën drejt qiellit e shtinte nën krahë Veleçikun e Rozafën, kur brigjet e Bunës avullonin e qyteti rropatej nën tingujt e kabanave, midis turmës shtrinte hapin një djalosh tërë gjallëri, që, me çantën në krah, merrte udhën për në shkollë. Gëzonte një shëndet të mirë. Në fillim i vinte rëndë të dilte ashtu i rreko-sur, prandaj rrëshqiste rrugicave me mure të larta, të cilat dukeshin sikur ishin bërë qëllimisht për t'u struktur pas tyre të varfërit... Po midis të varfërve s'kishte përse të turpërohej edhe Vojua gjunjë-jashtë...

...Kur zilja lajmëronte mbarimin e mësimit të ditës, Vojua hidhte krahut çantën me gjalmë e, i rrethuar nga çamarokët e lagjes, kthehej në shtëpi. Të gjithë e donin. Ndonëse ishte truprëndë, që i zhdërvjelltë, si atlet. Disa nga tregëtarët e tallnin, jo në sy, se nuk guxonin, po pas kra-

hëve. Ata e kishin bërë zakon ta merrnin nëpër gojë e ta quanin «leckaman i lindur për hamall». Porse djali i Shkodrës-loce, që dukej sikur lëshonte shtat çdo ditë, tani kish filluar të ëndërronte për t'u bërë shembëll burrërie... Vitet ja lëshonin vendin njëri tjetrit dhe rrjedha e tyre e gatoi Vojon me virtute të larta. Zëri i tij kishte një notë burrërore. Fjala e tij zinte vend te moshatarët e vet.

— Kanë me ardhë ditë të mira, o shokë, porse jo nga qielli. Qe, besa, keni me pa. Me krahët tonë do të fitojmë atë që na duhet me jetue, porse tash na duhet me bashkue grushtat. Grushti duhet të jetë aq i madh dhe i fortë, sa të shembi malin; ndryshe mbreti nuk e liron fronin.

— Ti ke fillue me folë kundër mbretit e mbreti ka burgje, ka hekura. Do të na lesh vetëm, — i thoshin shokët.

Bisedat e Vojos kundër mbretit kishin mbushur Shkodrën dhe shënjestra e spiunëve ishte graduar drejt këtij djaloshi. Po liria nuk mund të lidhet me pranga. Dhe ai, që nuk u trembej prangave, e ngrinte gjithnjë e më fort zërin e tij, zërin e klasës së tij.

— Ju thashë: mbreti asht një hajdut me çizme. Mos pritni të mira prej tij. Bir i këtij kombi asht ai që punon me përmbysë mbretin.

Shokët çuditeshin për besimin e guximin që kishte Vojua. Shpesh, në rrugicën për në shtëpi, ashtu siç ishin bashkë, takonin furrxhiun me shapkën e rrasur deri te veshët dhe me cigaren në anë të buzëve. Vojua e ngrinte më fort zërin, që të dëgjonte edhe ai.

— Djalosh, djalosh, — ja priste furrxhiu, — po të them për herë të fundit: në rrugicën time mos folë kështu mbarë e mbrapsh. Mbretin mos e shaj. A po ndin?!

Vojua kthente kokën qetë, e përsëndeste dhe vazhdonte në punën e tij. Në orën kur Vojua kthehej nga shkolla furrxhiu ndodhej gjithnjë në kassollen e zjarrtë. Një ditë, dy, tri... dhe furrxhiu i foli:

— Kam me të porositë për diçka. Hajde pak në furrë.

Si u përsëndet me shokët, djali i shkoi pas furrxhiut. Për të parën herë ai u njoh me këtë furrxhi të çuditshëm.

Biseda qe shumë interesante. Për të parën herë Vojua mësoi se, për të luftuar kundër regjimit, duhej bashkuar, duhej punuar me ngulm dhe duhej vepruar në mënyrë që të mos i bihej armikut në sy.

— Na, merri këto fletë. Lexoji me kujdes. Le ta shtojmë familjen tonë të revolucionit dhe le të ecim me guxim e këmbëngulje drejt qëllimit tonë. Na kena një mësues të madh — Leninin. Fjalët e tij janë busull. Po qe se ti ke vendosë me i shërbye popullit tand, ven dorën në zemër e ban një betim se nuk do të mundë me të thye as furtuna ma e rreptë.

Vojua dëgjonte me vëmendje dhe çuditëj: furrxhiu, që deri atëhere i kishte folur të rrinte urtë dhe të mos e zinte në gojë mbretin për të keq, i doli ndryshe!.

— A kena shokë të tjerë? — pyeti Vojua me ndrojtje.



— Shumë, gjithë proletarët e Shkodrës, të Shqipnisë, të botës... Po nuk e kuptojnë të gjithë menjëherë se nga asht shtegu që të çon te liria e te begatia. Ata duhet të kenë një shtab në krye, shtabin komunist. Nuk do të jetë vonë dhe do ta kemi edhe ne këtë shtab: partinë tonë komuniste!

—Partinë komuniste!

— Po.

Vojua mësoi shumë atë ditë. Ai mësoi se çdo veprim duhej të kishte një qëllim, çdo veprim duhej të studjohej më parë. Dhe doli nga furrxhiu me zemër të ngrohtë. Sapo kapërceu prakun, i hodhi një sy tabelës së nxirë sipër portës dhe lexoi edhe një herë emrin e njeriut që tani i kishte hyrë në zemër: «Vasil Shanto».

\* \* \*

Gjimnazi i Shkodrës kishte shumë nxënës. Midis tyre, Vojua shquhej për vullnet e shkathësi.

Një mëngjez prilli, mbi 400 nxënës ishin mbledhur përpara konviktit për të bërë fiskulturë. Mësuesi i fiskulturës, një burrë shumë i shëndoshë, e afroi Vojon pranë vetes dhe, me grushtin e fortë, i ra në muskulaturat e krahëve. Djali nuk u tund.

— Ja, ky ka trup të fortë. Duhet ta çojmë për artilier. Mbretit i duhet një trup si ky.

— Jo, zoti profesor, ky trup asht i klasës punëtore të Shkodrës dhe...

— Nuk t'u drejtova ty. Ti duhet të krenohesh që të jesh oficer i mbretit.

Vojua u skuq në fytyrë dhe në gjoks nisi t'i vlojë dëshira për të vazhduar bisedën.

— Ma mirë hamall i qytetit tim. As nuk kam mendue ma shumë se kaq...

— Duket je fry prej të kuqve. Mblidhe mendjen e mos merr më qafë veten, rininë tande.

Nxënësit dëgjonin fjalët e Vojos dhe vura re si u skuq nga zemërimi mësuesi i fiskulturës, Alush Leshanaku.

— Nuk thoni keq, zoti profesor, unë jam me flamurin kuq e zi, dhe, po të kisha një shtizë të naltë, do ta çojsha në qiellin e shtatë...

I zemëruar, mësuesi i tha të shkante në vend.

Gjakftohtë, Vojua nderoi dhe u drejtua për në rreshtin e vet.

Me qindra sy u kthyen nga ai.

\* \* \*

Në thellësi të rrugës, e cila nga larg dukej sikur ngushtohej, ndodhej një shtëpi e vogël, çatia e së cilës fillonte drejt mbi murin e avllisë.

Ishte mbrëmje. Në horizont ngrinte kryet Rozafa, më e lartë se kampanoret e minaretë. Kurrit të Taraboshit rrëshqisnin rrezet e hënës. Qyteti kish rënë në qetësi. Në rrugicë, më të rrallë, hynte ndonjë qytetar me veshje të thjeshtë. Trokiste në shtëpinë e vogël, hynte në derën e avllisë, në njërin sofat të së cilës rrinte një punëtor i duhantores së Shkodrës. Ndërsa përshendeste miqtë, ai ua ngulte vështrimin në bebe të syrit. Pas pak u ngrit; fërkoj duart dhe i ra rrugicës poshtë e përpjetë. Pastaj u kthye e hyri në shtëpi.

Në dhomën e vogël, në vatrën e së cilës xixëllonte zjarri e në oxhak një llambë me vajguri

lëshonte një dritë të venitur, ishte një rreth jo i vogël miqsh. Ata rrinin në truallin ku ishin shtruar dy hasra. Ishin pothuaj të gjithë njëzetvjeçarë.

— Erdhi Tarzani?<sup>1)</sup> — pyeti Veliu<sup>2)</sup>, që ishte në krye të vëndit.

— Jo, nuk duket, — u përgjigj ai punëtori i duhantores.

Të gjithë u panë sy në sy. Ndoshta mendja u shkoi për të keq: «Po sikur...»

— Duhet të vijë, — u dha zemër shokëve Veliu. — Ndoshta ka dalë bregut të Bunës... mos e ka zatetë ndokund e na presin kot. Në breg u ndien ca krisma, — tha Veliu me një ton më serioz.

— Ato i mora vesh unë, — ndërhyri punëtori. — Një malësor vrau dyqanxhiun e vajgurit, sepse i kishte ngranë lekët e qirasë. U vra për dy lekë e gjysë fajdexhiu.

Në këto biseda e sipër, në rrugë u ndje një fishkëllimë, që shkërbente melodinë e këngës «Kaj-rafilat që ka Shkodra». Të gjithë vunë vesh. Njëri brofi në këmbë. Ndërkohë, Vojua, me flokët e shkapërderdhura, hyri në dhomë. U ngritën të gjithë. Vetëm Veliu s'luajti nga vendi.

— Mirë se rrini, shokë! Pse shikjoni ashtu?

— Mirë se erdhe! — u përgjegjën të gjithë.

— Po ti, shoku Veli, ç'ka ke që rrin ashtu i mërzitun? Mos të asht djegë furra?

Veliu ktheu kryet pak si i mërzitun.

— Kujtova se të përpiu ndonji krap prej atyne të Bunës.

— Ora asht plot... — tha ai.

---

1) Kështu e thërrisnin Vojo Kushin.

2) Me këtë emër e thërrisnin Vasil Shanton.

— Po të vijshe një minutë ma parë, s'do bajshe keq. Në revolucion edhe minuta ka randësi... Po le t'i lamë këto.

Vojua zuri vend pranë Veliut dhe i zgjati një paqetë «Tatli Sert».

— Paske ra në lekë... ë?...

Djali uli kryet i bërë flakë. Ai, edhe kur takohej me shokët, skuqej në fytyrë, pa le tani që bisedat kishin edhe nga një thumb.

— Na bane merak, mor Vojo. Na të duem fort. Tash që ke me u largue, malli do të na shtohet. Kjo asht nata e fundit...

Pastaj u hodhi nga një vështrim shokëve.

— Fillojmë, shokë?

— Gati, — u dëgjuan zëra si në kor.

— Shokë, Komiteti Qendror i partisë ka urdh-nue që komunisti Vojo Kushi të transferohet me një detyrë të re në kryeqytet. Ky asht një nder i madh për shokun e vëllaun tonë, nder i madh për qytetin tonë... Na i urojmë rrugë të mbarë Vojos dhe e porositim që, kur të takohet me shokët, t'u thotë se djemt e Shkodrës-loce, ashtu si i mëson partia, do ta çojnë nalt e ma nalt flamurin e lirisë. Do të luftojnë si u ka hije e, po qe nevoja, për të naltësue emnin e partisë, do të japin edhe jetën...

Vojua i dëgjoi me vëmendje fjalët e Veliut, i vështrroi shokët me radhë, sikur po u jepte heshtazi lamtumirën, e tha:

— Shokë, të keni besim se urdhnin e partisë do ta çoj në vend. Edhe pse larg, unë do t'ju kem këtu në zemër. Këtu në zemër do ta kem edhe Shkodër-locen, edhe Rozafën tonë, edhe... Do të

më frymëzojnë për me kalue të gjitha shtigjet. Do të luftoj, shokë, pa u frigue, për lirinë, për komunizmin. I jam borxhli partisë për besimin që po më jep...

Njëri nga shokët dha një raport mbi punën e bërë, të cilin Vojua do t'ua dorëzonte shokëve në Tiranë. Pastaj përsëri e mori fjalën Veliu.

— Nisja do të bëhet në mënyrë shumë sekrete. Na ndjekin, shokë, po revolucionin nuk mund ta thyesh me spiunë. Ai rrjedh më vërtik si rrëketë e maleve, Sidoqoftë, duhet shumë kujdes. Duhet me ruejtë veten dhe shokët. Nesër do të veshësh rrobet e hamallit, ashtu si janë lecka-lecka, do t'i qethësh edhe flokët tas. Në mëngjez, ne nuk do të shihemi ma. Te depua e miellit do të takohesh me shoferin që drejton maqinën. «Trentakuarto<sup>1)</sup>», që ka mbi turi një luan. Do t'i thuesh: «Të hedh edhe tre thasë?», «Jo, s'ka nevojë. Hyp vetë». Me këtë parullë e kundërparullë jeni kuptue. Ngjitu në maqinë, mbi thasët me miell, dhe rruga e mbarë. Po qe se i kalon pritrat deri në Tiranë, do të shkosh në rrugën e Bamit, që e kanë «nderue» me emnin «Konte Ciano», më shtëpinë Nr. 300, te plaka e Kusakëve. Ajo asht serte, po ti ngul kambë e me çdo kusht të takohesh me Balilin. Asht një i ri flokë-verdhë e kuqalosh në fytyrë. Asht ose jo tetëmbëdhjetë vjeç. Me t'i dhanë dorën, t'i thuesh: «Veliu të çon selam. Tarasi si asht?» Besoj se jemi të qartë.

— Po, shoku Veli.

— Bukur. Hajde, «berber», shkurtoja kaçu-

---

1) italisht, tridhjetekatër

rrelat, se na i turbulloi çikat e Shkodrës me këto baluke...

Vojua qeshi. Njëri nga shokët shpalosi një shami të madhe dhe nxori një maqinë qethëse, i fryu krëhërit dhe ju afrua Vojos:

— Ul kryet. Ashtu. Rueji për kujtim në xhep...

Maqina lëvizi dhe flokët, palë-palë, ranë mbi hasrat. Pas pak koka e Vojos ishte bërë tas.

— Tash dhandri u qeth. S'ka gja se pa kangë. Po këndojmë me zemër. Silleni «kostumin», ta shofim se si do t'i vijë. Duhet ta ketë qepë mirë-terziu. Si thue, Sokol?

— Rrallë gjen në tanë Shkodrën si ky, shoku Veli.

Ai mori nga dollapi një shami, i zgjidhi cepat, shtroi në shesh një palë pantallona si t'i kishin ngrënë qentë, e një xhaketë me një dyzinë arna. Vojua nuk e mbajti gazin.

— Qe, besa, ky rrobaqepës asht i talentuem. Me këto rrobe mund të luejsh në pjesën «Peshkatarët e Vollgës».

— Hajde, se duem me të pa «dhandër» — vazhdoi Veliu. — Vishu shpejt.

Vojua hoqi rrobat e tij dhe veshi ato të «hamallit». Gjupjët i delnin jashtë dhe anës i vareshin rreka.

— Edhe në fytyrë duhet të nxihesh, kurse rrobeve hidhu edhe ca miell. Qysh prej kësaj ore ti je hamall... E çfarë hamalli, ma i miri në Shkodër! Veç mos harro se mbi supe mban diçka të madhe, Tarzan, mban detyrën që të ka dhanë partia.

91. — E kuptoj, shoku Veli. Na të gjithë bashkë e

mbajmë mbi supe atë dhe do ta çojmë nalt. Veleçiku do të përmendet ma pak për kah naltësia...

... Mbledhja u mbyll vonë. Të gjithë përqafuan me radhë Vojon, bashkuan duart e i uruan udhë të mbarë.

I pari doli nga dera Veliu, kurse i fundit, Vojua. Ai, si hije nate, rrëshqiti rrugës drejt veriut.

Hëna kishte perënduar. Një erë e ftohtë i fshikulloi fytyrën Vojos, i cili kishte futur duart nën kindat e pëlltos. Kindat copë-copë lëkundeshin si fletëza gati më të rënë. Kaloi heshtazi rrugën, e mori udhën drejt perëndimit, për te depua e miellit, u kollit dy herë dhe zbriti tej, rrëzë Bunës. Dy varka peshkatarësh po ktheheshin nga gjuetia. Peshkatarët qeshnin, hargaliseshin e tërhiqnin rrjetat e rënda. Siç duket gjuetia u kish shkuar mbarë.

Vojua u afrua rrëzë një shelgu dhe u shtri të pushonte.

\*\*\*

Më në fund qyteti u zgjua. Dielli nxori synë mbi mal dhe bregu i Bunës shkëlqeu. Vojua fërkoj sytë u shkund pak dhe shkoi te depua e miellit, ku hamallët venin e vinin me thasë në kurriz. «Ja probatinat e mi». Maqina «Trentakuatro», me luanin e bronxtë në turi, ishte e ngarkuar dhe shoferi po e fshinte me një leckë të lagur me benzinë. «Hamalli» i ra rreth e qark maqinës e ju afrua shoferit.

— Të hedh edhe tre thasë?

— Jo, s'ka nevojë. Hyp vetë.

— Asht e re dhe kujtova se mban ma shumë

se të tjerat, — tha e tundi kokën në shenjë miratimi.

— Thasët të m'i ruesh me kujdes, përndryshe, asnji pare nuk të jap, Ndigjove?

— Si urdhënon, zotnia juej, — dhe fytyrën e bëri tërë miell. — Tash, në dimën, flokët duhen pre, se s'ke ku i lan e bahesh pis, ma mirë me numër zero, — dhe preku kryet e qethun.

Maqina shungulloi pak dhe pastaj mori udhën drejt jugut. Lart, mbi dengjet e miellit, ishte vetëm «hamalli», me fytyrën gjithë miell e rrobat lecka-lecka.

Pas krahëve mbeti Shkodra, Rozafa...

Ndërsa vërtiste me gjallëri timonin, shoferi ndjente edhe frikë, edhe kënaqësi. Ai nuk kishte prapa shpine vetëm dengje mielli, po edhe një «minë» të fuqishme, që do të vendosej në themelet e armikut e do të shpërthente për ta hedhë në erë...

Me të hyrë te ura e gjatë, në këmbëzat e së cilës shkumonte ujët e lumit plak, një nga karabinierët i bëri shenjë me dorë shoferit që të ndalej:

— Ej, ragaco...<sup>1)</sup>

— Buonxhiorno, sinjore,<sup>2)</sup> — u përgjegj shoferi me buzë në gaz.

Karabinieri hyri në kabinë, vështroi majtas e djathtas dhe nuk foli fare. Ai as që i hodhi sytë sipër ngarkesës. Edhe shoferi nuk e ngacmoi me fjalë. Pastaj u nis.

Në të hyrë të Milotit, Maqina u ndal. Shoferi zbriti me të shpejtë, shkoi te një dyqan i vogël, bleu disa fraxholla dhe u kthye.

1) Ej, djalë!

2) Mirë dita, zotëri!



— Merri këto. Ndoshta ke uri, — i tha «hamallit». — Veç kujdes thasët, — dhe motori gumëzhiti përsëri.

«Duket se i kaluam pritat e vështira». — mendoi Vojua. Po, në këto e sipër, maqina u ndal përsëri. Shoferi doli nga kabina dhe, si u vërtit rreth e qark maqinës, tha:

— Duket se na la në udhë.

— Pse, ç'ka ndodhë? — pyeti i qetë «hamalli» dhe zbriti.

— U prish, — tha shoferi. — Eja të shikosh.

Të dy bashkë u shtrinë nën maqinë, sikur vërtet të qe prishur diçka. Ndërkohë, shoferi i pëshpëriti ngadalë:

— Ndigjo, se maqina s'ka gja, po kij mendjen përtej, në rrugë, se nuk do ta kemi të lehtë. Atje asht një postbllok dhe kontrollon një italian, kapteri Basidora, të cilit nuk i shkon as miza nën hundë. Të kontrollon letërnjoftimin e xhepat, nganjëherë të fut duart edhe në pantallona. E më duket se sot asht ai që kontrollon.

Vojua, duke e vështruar shoferin drejt në sy, i tha:

— Epo mirë, edhe ne mund ta rregullojmë atë. t'i gjejmë ndonjë sinjorinë nga ato të përtejdetit...

— Mirë thue, — vazhdoi shoferi. — Asht mirë të presim autobuzin. Kur bleva franxhollat, e pashë që ishte ndalë në Milot. Ne e ndjekim prapa. Kur të afrohem, ti kafsho franxhollat si i uritun e mbushe gojën sa të mos mundesh edhe me folë. Nuk turpnohem, le të na quejnë si të duen.

Pas krahëve u ndje boria e autobuzit.

— Ngjitu nalt, — tha shoferi. — Erdhi.

Hamalli kërceu mbi maqinë e nisi të hante franxhollën. Kur autobuzi kaloi disa metra, edhe maqina e tyre i shkoi pas. Në postbllok u duk kap-ter Basidora, i cili po tundte në duar një kër-baç me ruaza. I erdhi përqark autobuzit e pas-taj doli te dera. I pa udhëtarët me radhë. Për fat, në autobus ishte sinjorina<sup>1)</sup> Kaldoni, një e njohur e tij e vjetër, që e bënte shpesh udhën Shkodër-Tiranë. Kapterin e pushtoi një gëzim i madh.

— Ho, ho, Buonxhiorno, mio kuore!<sup>2)</sup>

— Karo mio,<sup>3)</sup> — u përgjegj buzëkuqja.

Kapteri kërceu në autobus dhe as që u kujtua se kush vinte pas. Ai as që e dëgjoi zërin e motorit të «Trentakuatros», që rrëshqiti me një ngarkesë të «thjeshtë» dengjesh mielli e me një «hamall» sipër. Drejt Tiranës kishin shkuar dhjetra maqina dhe në asnjërën ai nuk takoi ndonjë komunist. Edhe kjo si të tjerat...

Udhëtarët e humbën durimin dhe nisën të flasin me zemërim: «Të niset, të niset...» Po kap-teri as që ua vinte veshin. Ai bisedonte shtruar me zonjushë Kaldonin dhe s'i binte ndërmend për ta.

— Lirojeni autobuzin, i dashur, lirojeni të ikë. Unë po qendroj me ty, — tha ajo dhe kapteri, i gëzuar, i bëri shoferit me dorë për t'u nisur.

Ai e mori gati pushtuarazi buzëkuqen me fus-tanin mbi gju dhe shkuan në kafene. Malësorët që ishin aty, lanë kafetë përgjysmë dhe ikën. Tani ishte kapteri mbreti i lokalit...

---

1) Zojusha.

2) Mirëdita, zemra ime!

3) I dashuri im.

— Këtu të jesh e qetë, nuk kalojnë dot komunistët. Përpara meje nuk kalon as dreqi. Jo kot ma kanë besuar këtë detyrë, po... më mërzit vetmia. Tani që të zura, nuk të lëshoj më.

— Unë erdha vetë, më kishte marrë malli. Po... këtu qenka vështirë, duket sikur po të përpijnë malet. Ruajna zot! Vise të egra këto e të tmershëm më duken këta shqiptarët me qeleshe të bardha e opinga lope. Thonë se, po të zunë ngushtë, të djegin sytë me cingare.

— Po. Dhe pastaj të varin në lisa, të lyejnë me mjaltë dhe të lëshojnë bletët. Po ti mos u tremb, ua ndreq unë qejfin atyre. Pastaj... komunistët e Shqipërisë mbaruan! — Dhe kapteri ngriti me fund edhe një gotë verë.

Ndërkaq, maqina rëshqiste drejt Tiranës. Pas pak u duk edhe Dajti. «Mbritëm ma në fund», mendoi Vojua, po në çast ndjeu përsëri një farë shqetësimi: në udhë u dukën dy karabinierë, si të ishin vënë roje për të pritur maqinën. Njëri nga ata i bëri shoferit me dorë që të ndalej.

Shoferit ju rrëngqeth trupi. «Gjithçka mori fund, — mendoi. — Lajmi për «hamallin» tim paska udhëtuar më shpejt se maqina». Po menjëherë e mblodhi veten, buzëqeshi si me dashamirësi dhe hapi derën.

— Urdhëroni.

Karabinierët panë njëri tjetrin në sy dhe kërcyen në maqinë. Njëri me fytyrë vrarëlie u tregua edhe i sjellshëm: nxori paqetën dhe i dha shoferit një cigare. Ndonëse nuk e pinte duhanin, shoferi nuk ja ktheu dorën.

Një copë udhë e bënë heshtazi. Dhe nga njëherë heshtja të duket sikur të zë frymën, sikur

të lidhet gryka me litar. I pari foli njëri nga karabinierët.

— Sa vjet kini shofer? — pyeti.

— Dy. Tani sapo mbusha dy.

— He, e sheh? Musolini ju pruri fatbardhësinë, — tha italiani me krenari.

— Dhe do të shohësh si do të bëhet Shqipëria paskëtaj. «Albania é nel mio cuore»<sup>1)</sup> ka thënë Duçja. Ti qenke djalë me perspektivë, ke nisur të flasësh italisht...

Ndërsa shoferi i përgjigjej italisht në mënyrë që t'i zhdukte çdo dyshim, maqina kishte hyrë në rrugët e Tiranës.

— Mbajeni këtu, — tha karabinieri tjetër dhe, pasi falnderuan, zbritën.

Shoferi mori frymë lirisht dhe ja shkeli gazit. Pas disa kthesash nëpër rrugicat e Tiranës, u ndal në rrugën e «Bamit», në hyrje të së cilës ato ditë ishte vendosur një tabelë e bardhë me mbishkrimin: «Rruga Konte Galeaco Çiano». Shoferi e mbajti maqinën anës rrugës dhe u afrua të lexonte tabelën, kurse Vojua, me të arritur, u ngrit të shkonte në punë të vet. Ndërkaq shoferi hyri në maqinë dhe filloi të fshinte ngadalë xhamin e dërsitur, duke e hedhur vështrimin nga «hamalli», i cili ecte trotuarit si i lodhur. Në këtë çast, çast ndarjeje, ai ndjente një zë, zë që i buronte nga zemra: «Dalsh fagebardhë, Vojo. Mos e harro udhën që bëmë bashkë. Përsëri do të takohemi. Vojo, edhe unë jam ushtar i revolucionit ...»

Dhe ushtarët e revolucionit me të vërtetë ishin shumë. Ato ditë ata i binin atdheut kryq e tërthor

---

1) «Shqipëria është në zemrën time».

për t'u lidhur me besa-besë në luftë për çlirimin e trojeve që u kishte shkelur i huaji.

\* \* \*

Ndonëse dera e avllisë trokiti disa herë, plaka e Kusakëve nuk u ngut. Ajo, si i lajmëroi miqtë se dikush po trokiste, hodhi në sup çarçafin dhe doli në oborr. Përballë saj u duk një djalë me trup të bëshëm e me rroba copë-copë.

Plaka rrudhi vetullat.

— Ç'kërkon, more i paudhë? Largohu!

— Nanë, kam punë te ju.

— Te na punë, ti, rrugaç!

Po Vojua, megjithëse i erdhi rëndë e u skuq në fytyrë, përsëri foli:

— Nuk iki, kam punë.

— Ikë, more! S'ke punë ti këtu!

Vojos, që s'i kishte ndodhur kurrë kështu, iu lidh fjala në grykë, s'dinte ç'të thoshte. Megjithatë nuk u largua.

«Ç'e pruni këtë të çakërdisur këtu në derën time», — murmuriti plaka me vete. Pastaj hyri në dhomë. Tre shokët — Balili, Sokoli dhe Telua, të cilët diç po lexonin, u ngritën me të shpejtë, morën armët në dorë dhe u afruan prapa perdeve. Ata i kishin dëgjuar fjalët e plakës, po nuk shqetësoheshin fort: kur ishte rrezik, ajo dinte t'i njoftonte me anë shenjash.

— Ç'më rrini ashtu si të shtangun! Nuk e shifni beterin që s'largohet nga dera? S'lashë gja pa i thanë, po nuk i mbushet koka. A po del ti,

Balil, e përzene. Mos e sill brenda se kindat do t'i ketë tanë pleshta e s'kam kohë të laj pleshtat e tij. More vesh ç'të thashë? Mos e sill brenda!

Balili hodhi krahëve një xhaketë të vjetër, futi nagantin pas mesit dhe doli në oborr. Ju afrua ngadalë të panjohurit dhe, si ja nguli vështrimin drejt e në sy, i tha plot seriozitet:

— Po ty, more djalosh, ç'të ka sjellë rruga këtu?

— Kam punë. Nuk i rashë kot kësaj dere. Bile më kanë thanë bash te shtëpia Nr. 300.

— Mirë. Po kë kërkon në këtë shtëpi? — e pyeti Balili, i cili po e shikonte me vëmendje.

— Thonë se këtu jeton një djalë me emnin Balil.

— Balil!

— Po, Balil.

— Po në qoftë se është, çfarë kërkon prej tij?

— Ai ka ble një kalë. E ai asht imi, e kam pasë humbë gjashtë muej ma parë.

Balili bëri buzën në gaz.

— Jo, të kanë rrejtë. Balili shiti kalin e vet. Po, meqë je fukara, po të ndihmoj të kërkosh kalin, — dhe Balili çeli derën e avllisë.

Plaka e Kusakëve i pa që nga dritarja e me të shpejtë mori një ndejtëse dhe e qiti në oborr. I shkeli synë Balilit që të mos e fuste brenda, po ai bëri buzën në gaz e, bashkë me «mikun leckaman» hyri drejt e në dhomë. Sokoli dhe Telua prisnin në këmbë.

— Ja, më në fund, mbriti dhe Vojua. E njihni? — u tha Balili.

— E njohim, — dhe e përqaftuan me mall.  
Plaka, që ishte në sallon, kur pa sa ngrohtë  
e pritën shokët mysafirin, hyri brenda.

— He, ju qenkeni miq. Pse s'më treguat?

— Pa shikoje njëherë, ç'roje të sigurtë kemi.  
Është pak e egër po s'ka faj, e ka bërë koha  
kështu... — dhe u kthye nga plaka: — Po, moj  
nënë, ne jemi miq e shokë.

Si shkëmbyen disa fjalë, tre shokët i pro-  
pozuan Vojos të çlodhej. Ai u ul rrëzë vatrës, mbi  
një minder të mbuluar me një velenxë. I lodhur  
siç ish, menjëherë e kapulloi gjumi.

\* \* \*

Balili, si i porositi shokët të kishin kujdes  
për Vojon, mori biçikletën dhe shkoi drejt e në  
rrugicën e ngushtë ku banonte Tarasi.

Kur u kthye, Balili e gjeti Vojon siç e kishte  
lënë.

— Fle ende?

— Fle, — u përgjegj Sokoli. — Është i këputur  
nga udha.

— Duhet ta zgjojmë. Tarasi na pret në takim.

— Si është? — pyetën të dy shokët me një  
gojë.

— Si gjithnjë, i fortë e plot besim. Po, para  
se të dalim me Tarzanin, ju duhet të zini vend  
njëri në fund të rrugës së Dibrës, te kryqëzimi,  
tjetri te Pisha. Unë do të marr Tarzanin e do të  
vemi te Tarasi.

Shokët vunë revolet në xhep dhe dolën. Moti

ishte i errët. Vojua u ngrit ndënjazi, fërkoj sytë dhe u kthye në krahun tjetër. Balili i foli:

— Tarzan, çohu se po të pret Tarasi.

Djali brofi në këmbë:

— Kaq shpejt u ktheve? — i tha.

— Po shpejt, shpejt, u bënë tri orë...

— Tri orë! Pse nuk më kini zgjue?

— Shkova te Tarasi, më tha se të pret.

Tarzani i lëshoi sytë në kindat që kishte veshur e tha:

— Me këto?

— Aq më mirë, shoku «hamall»! Kur të bëjmë ndonjë dasmë, do t'i gjejmë një palë rroba edhe për ty.

Kish dasmë më të madhe për Vojon se sa të takonte shokun Taras, të cilit do t'i tregonte aq shumë për shokët e vet nga Shkodra?

— Besa, vështirë po e kam.

— Ai i do shumë leckamanët. Ke për të parë sa do të gëzohet kur të të shohë kështu.

— Po vetë, kështu rrin?

— Si të mundë. Ndoshta më keq... Herë si usta, herë si kallajxhi, herë me xhedike a me pantallona të grisura... Kjo është për ne veshja e kohës.

— Qe, besa, s'jam kah turpnohem. Na prij, se po nisena.

\* \* \*

Në rrugën e Bamit, drejt perëndimit, dy biçikleta rrëshqisnin njëra pas tjetrës. Balili shkante përpara, ndërsa Vojua njëzet metra pas tij.



Balili u fut në një rrugicë, frenoi dhe zbriti, kurse Vojua u ndal me gjakftohtësi pak më tutje.

Dera e vogël u hap. Në rrugicë doli një grua, e cila e njohu mikun e shtëpisë.

— Ti, Balil, qenke?

— Unë. Po nuk jam vetëm.

— Prit të lajmëroj...

— S'ka nevojë. Ai e di. Duhet të hyjë brenda ky miku i ri!

Mbas një copë herë u hap prap deriçka, doli Vojua e Balili e u hipën biçikletave. Shkodranit nuk ju durua, ktheu kryet edhe një herë para se të linte pas krahëve rrugicën, po nuk e pa atë që donte. Dy vajza qeshën midis tyre, ndoshta për kindat e Vojos që ja lëkundte era.

«Ky qenka Tarasi? Nuk ma merrte mendja. Sa i thjeshtë! Na e muerr zemrën, besa. Taras, Taras, ta dhashë besën! Besën tonë nuk ka furtunë me e thye», — mendonte dhe e ndjeu veten krenar si kurrë ndonjëherë tjetër. E ndjente se në këtë udhë kish shokë e drejtues të guximshëm.

Në kryqëzimin e rrugëve ata u ndanë, duke i thënë shoku shokut «Mirë u pafshim te rrobaqepësi».

Suati, i zoti i rrobaqepësisë, kishte shumë myshterinj. Te ai qepnin kostumet e tyre oficerë të lartë e nëpunës elegantë, po herë-herë edhe njerëz të thjeshtë.

Balili i dha dorën Suatit. Pastaj i paraqiti edhe të «vëllanë, që do të martohej ato ditë».

— Dua një kostum të mirë, veçse shpejt. Ndoshta ke të gatshëm?

— Sa të doni e si ta doni, zotërinj.

— Na zgjidh një ngjyrë blu me kuadrate të vogla.

Rrobaqepësi nxori një kostum të ri.

— Hë, vishe njëherë.

Vojua ju afrua Balilit e i ra me bërryl.

— Po këtë... — dhe i tregoi dorëzën e nagantit.

Balili qeshi.

— Është i «shtëpisë» rrobaqepësi, po hyrë e vishu.

Vojua i hodhi dyqanxhiut një vështrim të prehtë dhe hyri prapa perdës, nga ku, pas pak, doli i veshur si dhëndër.

— Edhe një kapelë republikë, — vazhdoi Balili.

Suati e pruri menjëherë.

— Pa vëre edhe këtë, — i tha.

Vojua e rregulloi kapelen e u pa në pasqyrë. Nuk u besonte syve, aq shumë i shkonin ato rroba.

— Tani drejt e te plaka. Të shohë edhe ajo se nuk jam rrugaç me pleshta...

Balili pagoi paratë dhe u nisën për në shtëpi.

Ishte vonë. Plaka e Kusakëve dhe fëmijët po flinin, kurse në dhomë prisnin Sokoli me Teli. Kur çelën derën, ata gati nuk e njohën Vojon.

— Ku je, more Vojo! Për besë, kanë me të rrëmbye vajzat!

Vojua uli kokën.

— Ku asht plaka? — tha Vojua.

— Po fle. Po do ta zgjojmë edhe nga gjumi.

— Jo, jo. Nuk ka lezet. Të rrijë rehat sonte, nesër prezantohem vetë. Të më shikojë mirë...

— Jo, besa, që sonte! — dhe njëri nga shokët kërceu në koridor.

Pas pak doli plaka duke fërkuar sytë. Vojua po rrinte në këmbë te minderi.

— Nuk më njef?

— Jo. Kurrë nuk të kam pa në derën time...

— Pa fërkoji edhe një herë sytë, mbase kujtohesh. Unë këtu jam rritë.

— Sytë i kam si xixa, po nuk po të njof. Ke ardhë ndonjëherë tjetër në shtëpinë tonë? Jo, jo, nuk më besohet.

— Tri vjet të shkume, — vazhdoi Vojua, ndërsa plaka po i afrohej ta shihte më mirë.

— Për tri vjet ti do të jesh rritë tri herë ma shumë e nuk të njoh. Dhe djemtë rriten si me i tërhekë për flokësh.

— Jo, besa, hiç s'jam rritë, veçse kam ndërrue lëkurën, — dhe hoqi kapelën.

Plaka shastisi.

— Ti more, je ba kështu?!

— Po tash 'a kam pleshta?..

— Tojbe jarebi, mos e thuej atë fjalë. Ti qenke pëllumb, — dhe ju hodh në qafë. — Kështu të paska hije. Qe besa, kur të mbaroni punët që keni nisë, kam me të gjetë një nuse si perri. Ke për të pë.

Të gjithë qeshën.

— A keni hangër, o Balil, me mikun? — pyeti plaka.

— Jo.

— Po pse s'kërkoni? Apo doni të lutuna si nusët me tela.

— Kujtuam se s'ka gjë. Ne i dimë hallet e shtëpisë sate. Pastaj ti e di se ne nuk duam të lutura për të ngrënë.

— Te ne as nuk ka, as nuk sosit, o Balil. Mandej sot që kishe mikun me vete, duhej të shpejtojshe pak. Ti e din se për miqtë nuk kurse-hemi.

Plaka hyri në kuzhinë dhe nuk u vonua të sjellë sofrën e madhe, të cilën e shtroi në mes të dhomës, sipas zakonit.

— Ç'bën ashtu? — tha Balili. — Ku e çon sofrën e madhe! Ne jemi vetëm dy.

— Ti rri urtë. Këtu jam unë e parë e shtëpisë. Hala s'ke mësue se, kur vijnë miqtë, edhe një i vetëm të jetë, shtrohet sofa. Mëso, se nuk do të rroj njëqind vjet, dhe mbaji mend të gjitha këto që të them, se edhe ju do të keni nuse e fëmijë, do t'ju vinë miq e duhet t'i dini mirë zakonet tona.

Tre ilegalë — Balili, Telua dhe Sokoli, — qysh se ishin vendosur në atë shtëpi, hanin bashkë me fëmijët e plakës. Ata, si dhe gjithë fëmijët e shtëpisë, afroheshin rreth sofrës, ashtu këmbëkryq, siç bënin të shtëpisë, dhe hanin ç'të kishte, pa bërë zë. Plaka nuk i ndante nga fëmijët e vet.

Si kishte vënë në sofër çka kishte shtëpia, plaka ju drejtua Balilit dhe mikut:

— Tash, bujrum! Hani këto që kemi. Filloni edhe këtë tas me fasule dhe u bafte mirë! Tjetër gja nuk kam. Po deshët, ka edhe turshi.

Balili u ul i pari pranë sofrës. Pastaj u ul edhe miku. Ai ishte i gëzuar: kurrë s'kishte takuar një rreth miqësor kaq të ngrohtë, një familje kaq mikpritëse. Madje ai mendonte se si ishte e mundur që, në mes të Tiranës, kjo shtëpi, pa marrë para-

sysh rrezikun, ishte kthyer në një çerdhe revolucionarësh.

Para se të dilte në dhomën e fëmijëve të saj, plaka i tha Balilit:

— Balil, ti ngre sofrën. Unë nuk po pres. Ja tek e keni qypin: po t'ju mbarohen ulla të tjerë. Tashma ti je i shtëpisë.

— Mos kij merak, nënë. Mikun e kam unë kujdës.

Plaka shkoi për të fjetur në dhomën e fëmijëve.

Si hëngrën darkë, të katër shokët u ulën çark menderëve e nisën bisedën. Vendasit i folën Vojos për punën që do të bënin, për shokët që kishin dhe gjëndjen e armikut në kryeqytet. Ai dëgionte me vëmendje. Rrallë bënte edhe ndonjë pyetje. Edhe ai u foli shokëve për takimin me Tarasin dhe sa të lumtur e kishte ndjerë veten në ato çaste.

— Ja dhurata e tij e thjeshtë, po e madhe. Në shenjë kujtimi e dashunië, Tarasi më fali nagan-tin e tij. E unë këtë do ta shkreh në rreshtat e parë të luftëtarëve të lirisë.

Kur më vonë ranë të flenë të gjithë, Balili shoi llambën dhe doli në avlli për të vrojtuar përreth. Nata ishte e ftohtë. Aty këtu qielli ishte i çelur dhe yjet dukeshin si filxhanët në tabaka. Natë shkurti.

\*\*\*

Ditët, njëra pas tjetrës, po afronin pranverën. Në avlli çeli kajsia e parë. Pranvera i ndehu krahët në të gjithë vendin. Pranverë në natyrë, po

dimër në jetën e popullit. Rrugicat e kryeqytetit, me të perënduar dielli, fashiteshin. Vetëm çizmet e rënda të milicëve e të karabinierëve ndiheshin nga mbrëmja në agim. Të dukej se qyteti nuk merrte frymë e kish mbetur pa jetë. Porse, nën hundën e shkelësit të vendit, bleta mblidhej në një degë të shëndoshë. Nën drejtimin e Tarasit, radhët e revolucionarëve shtoheshin. Nisën të gjëmojnë krismat e para. Ja, një mbrëmje u vra një spiun në rrugën e Elbasanit e, një mëngjez, një tjetër në atë të Shëngjergjit. Më vonë spiunët dhe tradhëtarët shtriheshin të vdekur në mes të bulevardit. Armiku dridhej. Edhe malet nisën të gjëmojnë. Po merrte flakë lufta për liri. Revolucioni kish hedhur shtat.

Armiku arrestonte, varte. Gazetat nuk pushonin së shkruari me gërma të mëdha: «Legjendë! Legjendë mbi një Parti Komuniste Shqiptare», «Të kuqtë mbaruan, të kuqtë mbaruan»... Po më kot: kryeqyteti ziente. Partia jetonte, rritej, luftonte. Aksionet e para ishin tërmet për armiqtë.

Në një shtëpizë në rrugën e Spitalit ishin mbledhur komunistët. Ata ishin një brigadë e fuqishme proletare, që kishte hedhur vështrimin në horizontin e gjerë e, me gjoksin e vet, kishte vendosur të përballojë furtuna e stuhi.

Në mbledhje e mori fjalën Mistua.

— Dje bisedova përsëri me Tarasin, — tha ai. — Erdhi koha, shokë, të hidhemi në aksione të gjëra, të mos i japim radhë hasmit të marrë frymë. Tarasi më ka porositur veçanërisht që, së pari, të rrëmbejmë një shtypshkronjë. Zërin e partisë, që po rritet çdo ditë, duhet ta çojmë me anë të

shtypit deri në kasollet më të largëta të atdheut. Duhet t'i zgjojmë malet tona. Por duhet guxim, shokë, zgjuarsi e gjakftohtësi. Për këtë, shoku ynë, Vojua, na ka folur me të gjitha hollësitë, prandaj edhe jemi mbledhur sonte këtu. Njësitit tani i është besuar kjo detyrë.

Gjithë shokët panë njëri tjetrin në sy me krenari. Edhe Balili ndjeu një kënaqësi në shpirt për besimin që u jepej për të kryer aksionin e parë, aq të rëndësishëm për partinë.

— Shumë mirë është menduar, — thanë shokët e njësitit me një gojë.

Pastaj, si u hodhi një vështrim shokëve me radhë, Mistua, i entuziazmuar që gjithçka shkonte ashtu si ishte menduar më përpara, u ngrit në këmbë e tha:

— Ne, shokë, ja kemi falur jetën Partisë. Nëqoftëse ndonjë prej nesh do të bjerë në krye të detyrës, flamuri nuk do të bjerë përtokë, shokët do ta ngrenë lart. Ne po çelim shtegun e parë e pas nesh do të ecë gjithë Shqipëria. Dasmë pa mihi nuk bëhet. Veç dua t'ju them, të dashur shokë, se zotësi nuk i thonë të hidhesh në zjarr, po të hidhesh në zjarr e të dalësh shëndoshë e mirë. Zotësi është kur ne do ta kemi kryer aksionin me sukses dhe shokët t'i shpëtojmë.

Mbledhja zgjati disa orë. Ishte mesnatë. Mihali u ngrit ngadalë, mori një çantë që e kishte sjellë Mistua, dhe e hapi. Në të ishin mbështjellë dy gjela deti të pjekur dhe disa simite. Bëri buzën në gaz dhe përsëri u foli shokëve:

— Këto i kemi dhuratë nga shoku Nako Spiru. Ai kishte shumë dëshirë të ishte sonte këtu me

ne, po, duke qenë se partia e ka ngarkuar me detyrë tjetër, nuk pati mundësi të vinte dhe vendosi të na gostitë. Siç e shihni, për ne është boll.

Njëri nga shokët mori një biçak dhe e rراسi në kofshët e gjelit. Kasap i vërtetë. I çau pjesë-pjesë të dy gjelat, pastaj ua ndau shokëve me radhë. Të gjithë së bashku, si të ishin bij të një nëne, hangrën darkën e bollshme.

Vonë, njëri pas tjetrit, u shpërndanë. Në dhomë mbetën Balili, Ramizeja dhe pesë shokë të tjerë. Ishte njësit i gueril që do të kryente aksionin: marrjen e shtypshkronjës. Ndonëse ishte vonë, ata nuk ranë të flinin, po biseduan shtruar për probleme të jetës e të punës.

Pas pak, njësit i u shtrua të bisedonte për hollësitë e aksionit. Mihali, të cilit partia i kishte ngarkuar, detyrën të udhëhiqte njësitin që do të kryente aksionin, vazhdoi:

— Ti, Ramize, si «bashkëshorte» e Balilit, si të jesh veshur e mbathur si e di vetë, do të shkosh me të krah për krah përmes bulevardit e të dy të qendroni përpara portës së shtypshkronjës. Duhet të kini parasysh se atje ka shumë roje, — vazhdoi duke ju drejtuar të dyve. — Prandaj të jini të gatshëm edhe për të papriturat. Pra, në çantën e dorës duhet të kesh edhe revolverin, madje, po që e mundur, edhe ndonjë granatë.

Vajza dëgjonte me vëmendje. Në sytë e saj shquaje guximin dhe krenarinë për detyrën që i besohej. Për trimëri nuk ja gjeje shoqën në kryeqytet. Ishte edhe me kulturë. Ajo e fliste italishten bukur, madje edhe me dialekte. Edhe frëngjisht nuk fliste keq. Sa për bukuri, i kishte të rralla shoqet.



— Molto bene<sup>1)</sup>, — u gjegj Ramizeja duke qeshur.

— Kështu pra, detyra është e qartë, — vijoi Mihali, — Një detyrë jo më pak të vështirë ka edhe shoferi. Ju e njihni Deliu. Ja tek e kini. Pa shikojeni: si ju duket? Guximi nuk i mungon. Edhe nga zanati nuk bie poshtë.

— Ja tek më kini. Nuk jua mbush synë? — qeshi Deliu. — Maqinën e kam të re, po mos ma merrni më sysh. Hë de, shikomëni... Jam shofer Deliu, i njohur në gjithë Tiranën, veçse më mungon diploma. Po edhe atë do ta kem më vonë...

Të gjithë qeshën.

— Fjalë të bukur the, o Deli, — ja priti njëri nga shokët. — Mos u tut, se nuk të merr më sysh njeri as ty e as maqinën...

Balili hera-herës bënte buzën në gaz. Në bisedat e shokëve, në gadishmërinë e tyre, ai shikonte se zëmrat i kishin të gatë me një vetëdije të lartë komuniste.

Ylli i mëngjezit xixëlloi në majën e Dajtit. Në ato çaste u ndje edhe «zogu i natës»: «fiu-fiu-fiu!» Balili brofi në këmbë, zbriti shkallët dhe çeli derën. Kop Myzeqari, pjesëtar i njësitit, si përshëndeti shokët, hyri brenda. U përqaftua me të gjithë.

— U vonova pak. Më ishte qepur prapa një milic dhe e pata keq punën, po, kur bëra kthesën në krye të bulevardit, e prita pak pas kasolles dhe, me një hekur kokës e lashë duke u përpëlitur.

— Të lumtë! Duket do të na shkojë mbarë, — tha Balili.

---

1) Shumë mirë.

— Të lumtë! Të lumtë! — u dëgjuan zëra si një kor.

— Po me gjumë si jini, kini fjetur? — pyeti Kopi.

Mihali dhe Balili dëgjonin me vëmendje. Bisedat s'kishin të mbaruar. Ata ja kishin çelur zemrën njeri tjetrit, si të ishin bij të një nëne. Ndonëse atë ditë do të provonin fatin në një shtëpi të rrezikshëm e, ndoshta, do t'u kushtonte jetën, ata bisedonin qetë, sikur paqja të ishte bërë mbretëresha e njerëzimit. Ata do të shkonin në grykën e vullkanit, po nuk trembeshin. I kishin dalë për zot popullit të tyre.

Mihali nxori nga xhepi një letër dhe, si e shtroi përpara në tryezë, nisi t'u tregonte shokëve udhën që do të bënin. Ai rrëfeu me hollësi nga do të tërhiqeshin të plagosurit, në rast se do të kishte të tillë, në cilën bazë do të shkonin dhe si do të organizohej mbrojtja e njësitit në rast se përlëshja e parë do të bëhej në komandën e mbrojtjes së kufirit, që ishte pranë shtypshkronjës.

— Për trimëri, s'kam ç'ju them, të dashur shokë. Veçse dua t'ju kujtoj atë porosi që gjithmonë na ka dhënë Tarasi: «Të jemi kurdoherë gjakftohtë, të mos alarmohemi në çastet e vështira dhe të shkojmë gjithmonë përpara».

Të gjithë dëgjonin me vëmendje.

— Tani mendoj të marrim një sy gjumë, — vazhdoi. — Edhe vapës do të flemë po këtu. Pasdreke do të dalim një nga një e nga drejtime të ndryshme dhe do të vemi afër shtypshkronjës. Tani duhet të organizojmë rojet. Ndërresën e parë mendoj ta marrë Ramizeja. Pastaj Kopi e me radhë. Mirë?

Të gjithë tundën kokën në shënjë miratimi, ndërsa Ramizeja futi revolverin në çantën e zezë llustrafin, mori automatikun italian me dy karikatorë dhe ju afrua dritares. Përtej dukeshin majat e qeta të maleve që vargëzohen deri tej Krujës. Shokët u shtrinë të flenë.

\*\*\*

Në krye të bulevardit u duk një çift i ri, që ecte qetësisht poshtë e përpjetë. Biseda midis tyre ishte e përzemërt. Shumë kalimtarë hidhnin sytë duke e parë vajzën nga këmbët në kokë. Mbi dy takat e këpucëve që trokitnin në trotuar, mbështetj një trup llastar, siç thonë. Fundi i saj mavi, që palosej fletë-fletë, dridhej pas trupit. Në qafën e gjatë e qumësht të bardhë i varej një zinxhir i florinjte me një kryq të madh, mbi të cilin xixëllonin disa gurë të kuq. Nga këto salltanete, të shkonte mendja se, në mos e bija, ajo do të ishte e mbesa e ndonjë hierarku të dëgjuar fashist. Dhe s'kish këtu ndonjë çudi: vizitorë të tillë në atë kohë Tirana kishte shumë. Madje thuhej se ato ditë paskësh ardhur në kryeqytetin e Shqipërisë edhe Eda, e bija e Musolinit.

Vajza sodiste me radhë shtëpitë anës bulevardit, ashtu siç bën çdo i huaj kureshtar dhe, herë-herë, i fliste shoqëruesit me një italishte sallonesh. Djali lëvizte kokën në shënjë miratimi e, tek i binin herë-herë në ballë baluket e verdha, përgjigjej me zë të lartë: «si, si... çertamente<sup>1)</sup>...» Ai nuk e

---

1) Po, po... sigurisht...

dinte italishten, prandaj edhe mjaftohej me dy-tri fjalë...

Cifti ktheu djathtas, la prapa Bankën dhe hyri në një rrugicë prapa postëtelegrafës, ku ndodhej shtypshkronja «Gutenberg».

Ishte mbrëmje. Nisi të fryjë një fllad i lehtë. Sahati i Tiranës ra tetë herë. Balili, shoqëruesi i «zonjushes», e pa drejt e në sy e diçka i pëshpëriti. Ajo tundi kryët me delikatesë. Ishin fare pranë rojes.

Ushtari, mbi helmetën e të cilit ngriheshin një tufë puplash gjeli, e soditi me kërshtëri vajzën e re nga koka në këmbë e, një me një, mendia i vajti te gjenerali, në portën e të cilit po bënte roje: «Qenka mikeshë e gjeneralit». Ai harroi të pyesë nga vini dhe ku shkoni. Ushtari italian i falej asaj bukurie më shumë se Krishtit... «Ndoshta kërkojnë ndonjë nga oficerët e komandës», — mendoi ushtari kur dy të rinjtë ju afruan shtypshkronjës «Gutenberg» dhe jo portës së gjeneralit, që ishte përballë saj.

Dhe ajo rrugicë ishte me të vërtetë e çuditshme. Në ndërtesën, nga ana e poshtme, ishte shtypshkronja «Gutenberg». Në katin e sipërm të saj banonte inxhinieri i shtypshkronjës me të shoqen. Ngjitur me të ishte Komanda e mbrojtjes së kufirit. në të cilën, veç ushtarëve e nënoficerëve, kishte edhe nja dhjetë oficerë, dhe ballëpërballë shtypshkronjës kish selinë e vet gjenerali italian.

Cifti vazhdoi udhën. Kaloi edhe disa metra matanë shtypshkronjës, sa për t'ju larguar vështrimit të ushtarit. Në këtë kohë Balili i tha vajzës:

— Na i ka qepur sytë roia. Bëj cmos t'i tërheqësh vëmendjen. Edhe revolverin mbaje gati.

— Mos u shqetëso. Që në sy duket se është tutkun. Për një femër ai është gati të dorëzojë edhe pushkën që mban në dorë. Mos ja ki frikën. Nuk e shikon? Është trëndelinë. Ja, shiko kur t'i afrohem.

Çifti shpejtoi hapin dhe ju afrua rojes. Një maqinë erdhi ngadalë dhe karrocëria u mbështet në portën e shtypshkronjës. Një shtullungë pluhuri u ngrit në rrugicë. Për t'u treguar i sjellshëm ndaj një femre që po ja merrte mendjen, ushtari i thirri:

— Sinjorina, sinjorina...<sup>1)</sup>

Vajza ktheu kryet nga ushtari.

— Afrohuni këtej, ka pluhur...

— Faleminderit, — tha «zonjusha» me delikatesë dhe bëri disa hapa nga ushtari, duke ju larguar pluhurit, që të merrte frymën.

Punëtorët zbritën ngadalë, çelën derën e shtypshkronjës dhe hynë brënda. Balili, që kishte vajzën në krah, rrinte qetë dhe vështronte buzagaz rojen. Ramizeja, për të larguar krejt vëmendjen e ushtarit, e çeli përsëri bisedën me një italishte të hollë.

— Djalosh, kini kohë që punoni në këtë shtypshkronjë?

— Jo, — e ndërpreu shoferi. — Ky është roje dhe jo punonjës i shtypshkronjës. Unë jam këtu dhe këtë ushtar të mirë nuk e kam parë asnjëherë.

— Nuk flas me ty, — vijoi vajza. — Vazhdo punën tënde, — dhe u kthye përsëri nga ushtari.

---

1) Zonjushë, zonjushë.

— Ju e njihni inxhinier Kaconin?

— Po. E njoh fort mirë. Mua më do shumë, — dhe e vështronte me zemërim shoferin, i cili s'duhej të merrte pjesë në bisedën me këtë buku-roshe...

— Anke io, sinjorina, anke io...<sup>1)</sup> — ja priti shoferi.

— Ju bashkëvendësi im jini?

Ushtari e kishte fjalën në majë të gjuhës; e quante veten me fat që i takoi të fliste me një zonjushë si kjo...

— Po, jam nga Kalabria. Më thonë Piero.

— Bukur. E gëzofsh emrin! Kini kryer shkollë?

— Po, sinjorina. Shkollën dyvjeçare speciale në Kalabri për shartim portokallesh. Madje, ditët e fundit, para se të më merrnin ushtar, një pronar kalabrez më paguante me flori për shërbimin që i bëja. Tani, siç e shihni, më hodhi era në këto vise...

— Njëlloj jemi. Edhe mua kështu më ndodhi.

— Po përse?

— Eh, fati! Si mbarova fakultetin e letërsisë në Universitetin e Romës, më hodhën këtej. Do të mbledh folklorin shqiptar, ta përkthej në gjuhën italishte. Thonë ka folklor të pasur, folklor fisesh të egra...

— Dini shqip?

— Si jo. E si mund ta kryeja ndryshe këtë punë?... Mandej... merrem edhe me punë të tjera... sekrete... dhe i shkeli syrin, duke i dhënë të kuptojë se fjala ishte për SIM-in.

---

1) Edhe unë, zonjushë, edhe unë.

— Unë, për vete, nuk e mësoj dot kurrë këtë gjuhë, — tha ushtari. — Gjuhë e egër, si vetë njerzit. Shumë e egër. Me këta njeriu duhet të jetë i pamëshirshëm.

— Nuk është krejt ashtu. Gjuha është e mirë, madje edhe poetike, porse këtyre njerëzve u kanë rënë në qafë gjithmonë të huajt... Gjithmonë është tallur Evropa me ta... Vetëm ne erdhëm këtu si «zbutës tigrash» dhe, me sa duket, ua kemi rrëmbyer zemrën. Shqipëria po bëhet një Itali e vogël. Si thua ti?

— Nuk do t'i arrihet dot kësaj, zonjushë. Këta të vrasin. Përgjegjësin tim të ndërresës, pastë ndjesë, kaporal<sup>1)</sup> Salkinin, e vranë komunistët një natë, i rrëmbyen dokumentin e postrojeve dhe gjithë armatimin. Më vonë e gjetën truprojnë në gjumë dhe i morën gjithë armët. Ka ditë që është përhapur si fara e hithrës komunizmi.

— Këtu komunizmi! — tha ajo si me habi.

— Si, sinjorina, tropo<sup>2)</sup>. Ju nuk i kini parë ende. Thonë se kanë ardhur nga jashtë, nga Rusia...

— Jo, nuk është e mundur. Komunistët nuk vinë nga jashtë, po mbijnë nga brenda. Vendës duhet të jenë, po që se ka të tillë.

— Unë nuk i pjell nga koka këto që them. Të gjitha sa dëgjove i ka thënë gjenerali ynë në mbledhje, tamam atë ditë kur na porositi ta ruajmë atë, si komandant të drejtpërdrejtë që e kemi, dhe njëkohësisht të ruajmë veten tonë e sekretin.

---

1) Tetar.

2) Po, zonjushë tepër.

— Ku është gjenerali juaj? — pyeti «zo-njusha».

— Ja, këtu mbi kokën tonë. E sheh atë dritaren e katit të tretë, që ka një perde të bukur? Atje fle gjenerali. Sonte nuk është këtu. Ka shkuar që mbrëmë në plazh. Ndofta kthehet.

... Automobili u largua nga rrugica. Brenda në shtypshkronjë, tërë natën, punëtorët e zbërthyen me kujdes maqinën dhe e afruan fare pranë portës. Kur më të rrallë ndonjërit i shpëtonte nga dora një çelës a kaçavidë dhe binte me zhurmë në çimento, të gjithë heshtnin e mbanin vesh se, ndofta, ndokush mund të trokiste në portë. Po ata e kishin vendosur që, nëqoftëse armiku do t'i merrte erë kësaj pune, do të luftonin me guxim dhe do ta kthenin shtypshkronjën në një kështjellë luftarake në zemër të Tiranës.

Rojet ishin ndërruar disa herë atë natë dhe asnjërit s'i ra ndërmend në ishte hapur dera e shtypshkronjës apo jo.

Ramizeja, si fshiu duart me një leckë me benzinë për t'i pastruar nga vaji i maqinave, ju afrua ngadalë Balilit dhe e pyeti:

— I erdhi radha mikut Petroni?

— Po, ka një orë e ca që ka marrë detyrën.

— Po ç'presim më? Maqina ka ardhur. Fillojmë ngarkesën.

Të gjithë shokët ngritën ngadalë maqinat e shtypshkronjës dhe i vendosën në automjet, kurse Ramizeja, e shoqëruar nga Balili, ashtu siç e kishte zakon, gjakftohtë e pa ju trembur syri, doli drejt e në rrugicë dhe ju drejtua ushtarit me një ton dashamirës.



— Mirëmëngjezi, mik.  
— Mirëmëngjezi.  
— Ju e kini radhën?  
— Po.  
— Gjenerali ende nuk ka ardhur?  
— Jo, zonjushe. Me të ardhur, unë do ta njoftoj se e kërkon.

— Faleminderit. Unë nuk do ta harroj kurrë xhentilecën tuaj. Ndofta, kur të kthehemi në atdhe, do të takohemi...

— Patjetër. Unë do t'ju kërkoj, zonjushe. Do t'ju sjell portokalle Kalabrie...

Ndërsa po bisedonin, njësitë e kishte vendosur shtypshkronjën në makinë. Deliu doli ngadalë përpara dhe hipi në kabinë. Balili, që e kishte njëzetshen pas brezit, bëri disa hapa prapa pa i kthyer shpinën ushtarit, iu afrua shoferit e, si futi kokën te dritarja e makinës, i tha:

— Gati?

Shoferi tundi kokën.

Pastaj thirri Ramizenë.

— Kini dëshirë të shkojmë në Durrës? Shoferin e kemi mik.

— Me gjithë qejf.

— Shumë mirë, — ndërhyri Petroni. — Atje do të takoni edhe gjeneralin tonë. Ndoshta ktheheni me veturën e tij.

— Atëhere, mirupafshim, Petron!.

Pranë shoferit zunë vend edhe Ramizeja me Mihalin. Deliu shkeli gazin dhe maqina lëvizi, u kthye majtas e mezi ju ngjit së përpjetës së vogël prapa Postëtelegrafës. Ajo kishte një peshë të rëndë. Përveç katër pjesëtarve të aksionit, kishte edhe shtypshkronjën, që peshonte mbi 10-12 quintalë.

Kur reja e pluhurit që la maqina u zhduk, Petronit i vanë sytë te porta e shtypshkronjës. Ajo ishte e mbyllur, si edhe më parë, madje e dyllosur, sikur s'kishte hyrë brenda as miza.

S'kaluan shumë minuta, kur u dha në portë inxhinieri tërë elegancë, me flokët që i shkëlqenin nga brilantina. Ai do të dilte shetitje.

Kur ishte ndërruar edhe roja e tretë, në rruçicë filloi një lëvizje e madhe. Nga të gjitha anët rrëshqisnin motoçikletat me kosha me mitrolozë dhe bersalierë me pupla gjeli. Porse ishte vonë: «Gutenbergu» ishte arratisur...

Si për çudi, me turmën e armatosur ishte edhe Petroni. Ai rrinte i heshtur, sikur s'dinte asgjë. Vetëm fjalët e «zonjushës» i zienin në kokë: «Komunistët nuk vinë nga jashtë, po mbijnë nga brenda...»

Nga ballkoni i Bashkisë mbante fjalë prefekti: — Ndigjoni, ndigjoni, zotërinj! Ndigjoni ju, popull, gjithë sa jeni këtu: vjedhje! U shteroftë fara e kuqe, që s'po na le rehat. Ndigjoni, komunistët janë hajdutë. Ja, zotrinj, vodhën edhe shtypshkronjën dhe e lanë në të katër udhët pronarin e saj që e kishte si bijë të vetme. Komunistët e kanë vjedhë shtypshkronjën dhe portën e kanë dyllosë. Ne e dimë, zotërinj, shtypshkronjën e vodhën komunistët. Ndigjomë, o miku im Saragon! Po të jem unë gjallë, të gjithë komunistët do t'i var këtu dhe shtypshkronja juej përsëri do të kthehet në vend. Komunistët janë të paerz. të pafe, pa din e iman, hajdutë. Kjo s'ka ba vaki: të rrëmbehet shtypshkronja e të lihet në katër udhët i zoti i saj!...

Populli qeshte. Disa andej nga fundi vërshë-

llenin. Ata e kishin të qartë se shtypshkronja kishite shkuar në male dhe atje do të shtypeshin traktet e partisë, nëpërmjet të cilave do të buçiste zëri i së vërtetës. Ata e kishin të qartë se ky ishte një aksion i guximshëm, që u krye me sukses mu përpara hundës së armikut. Dhe të gjithë hodhën sytë nga malet. Andej duhej tani, andej do të zbriste në kryeqytet liria...

\* \* \*

Korrik. Vojua, i veshur me rrobat e reja e me kapelë republikë me strehë kthyer mbi ballë, doli nga shtëpia ku kishte bazën dhe u nis të takonte Tarasin. Biseda do të ishte interesante. Vojua kishte lajme të mira atë natë. Do t'i njoftonte se aksioni i parashikuar prej tij u krye me sukses.

Kaloi ngadalë rrugën e Dibrës, duke mbajtur në dorën e djathtë një revistë italiane, mbi kopertinën e së cilës dukej një kërcimtare e bukur. Në xhepin e majtë kishte gazetën; nga pjesa që kishte dalë jashtë lexohej qartë «Fashi...» Kalimtarët e kujtonin atë si ndonjë student a nëpunës të kujdesshëm, apo, politikan të kohës. Vojua ecte gjakftohtë dhe herë-herë shikonte larg në rrugicë. Kur ktheu majtas për të hyrë në rrugicën e shtëpisë ku banonte Tarasi, ai pa vetëm disa fëmijë që loznin te një portë.

Shpejtoi hapat, ju afrua portës dhe trokiti. ...Tarasi i dha atë natë edhe një udhëzim për një aksion të ri e të guximshëm. Udhëheqja e partisë kishte menduar që, më 24 korrik, në të gjithë vendin të kryhej një aksion i madh kombëtar: të priteshin të gjitha linjat telefonike e tele-

grafike e kjo do ta ngrinte shumë autoritetin e Partisë në sytë e masave. Armiku do të paralizohet, populli në të gjitha skajet e atdheut do të entuziazmohej. Me këtë aksion do t'u jepej zemër edhe fqinjëve tanë. Aksionet janë kudhra e kalitjes së komunistëve. Tarasi i foli se si duhej të vepronin edhe njësitet guerile të Tiranës. Veçse duhej patur parasysh që ky aksion të kryhej me konspiracion të madh. Armiku kishte veshë të mprehtë. Ai kishte shpërndarë spiunë në të katër anët, që përpiqeshin të binin në gjurmët e komunistëve, e ç'nuk bënte për të asgjësuar partinë!...

\* \* \*

Të nxehta ishin ato ditë. Të duhej sikur qyteti kish mbi kokë një saç të nxehtë. Fëmijët, me teneqe uji në dorë, i vinin rrotull pazarit për të nxjerrë gjëkafshë nga fshatarët apo kalimtarët. Uji ishte i ftohtë, po mbante një erë të rëndë, se ishte nga puset. E ç'të bëje? Kështu jetonte kryeqyteti i Shqipërisë në ato ditë robërie.

Më 22 korrik, në një shtëpi rrëzë Lanës, erdhën gjithë komandantët e njësiteve guerilje të kryeqytetit. Në këtë mbledhje foli Vojua. Ai kishte bërë një plan të hollësishëm, zbatimi i të cilit do ta ngrinte më lart emrin e partisë. Ai tregoi se, po të vepronin në një kohë të tëra forcat guerilje, do të mund të kryenin një aksion të guximshëm, duke prerë të gjithë rjetin telefonik dhe telegrafik, sa që do t'i shtinin dridhmën armikut.

Vojua nuk foli për këtë aksion të gjerë kombëtar në përgjithësi, ai u përqendrua vetëm në aksionin që do të kryhej në kryeqytet.

ka trazira. Komunistët po mbijnë si farë e hith-rës. Aty këtu po kryhen aksione e po vriten shokët tanë. Më parë se të nisem për në Durrës do të siguroj mbrojtjen personale. Gjithashtu, edhe ju urdhëroni komandën e garnizonit të nxjerrë tri motoçikleta të armatosura në zonën e Vorës. Mir-upafshim!...»

Vojua tundi kokën dhe bëri buzën në gaz.

— E dëgjoni? U ka hyrë frika në palcë. Presin e përcjellin zonjat e tyre si në shtëpinë e vet; po, ama, edhe po e shohin se u dridhet toka nën këmbë. He, mor fashistë, po ju vjen dita!

Atë mbrëmje, Vojua dëgjoi shumë biseda nëpërmjet asaj kufjes së vogël.

Kaluan orët e para të mbrëmjes. Ato qenë të freskëta, siç janë zakonisht natët e kryeqytetit. Vojua kishte vënë përpara orën dhe priste me padurim të vinte dymbëdhjeta. Tërë emocion është njeriu kur pret të fillojë një aksion të madh. Dhe ja, çasti erdhi. Njëri nga shokët i bëri me shenjë se biseda me Shkodrën dhe me Kukësin u ndërroi.

Damarët e armikut u paralizuan. Jo, është pak të themi kështu; ato u prenë...

Vojua e dinte mirë këtë. Atë natë, më 24 korrik, në orën 24, komunistët e Shqipërisë prenë me guxim nervat e organizmit të bishës fashiste, duke e shndërruar atë në një trup të shkrehur, pa jetë, të paaftë për veprim.

— Çasti erdhi, shokë. Veproni! — thërriti Vojua.

Sharra rrëzoi shtyllën e parë, pastaj të dytën, të tretën e me radhë. Fijet telefonike u këputën dhe u shtrinë si tërkuza nëpër kodrinat rreth Tiranës. Kryeqyteti heshiti. Kryeqytetit s'e dëgjonte më as-

kush. Porse në këtë heshtje të madhe të armikut ushtoi më me forcë zëri i partisë.

Përpara se të gdhihej, Vojua me shokët e njësitit gueril u kthyen shëndoshë e mirë në bazën e tyre dhe u shtrinë të marrin një sy gjumë. Të gjithëve u digjnin duart, se u qenë bërë tërë flluska. Ata kishin prerë shumë shtylla, kishin tërhequr shumë tela...

Vojua shtrëngonte sytë, po më kot: nuk e zinte gjumi. Kur ke gëzim në shpirt dhe një ndienë krenarie për çka ke bërë për t'ja arritur qëllimit, edhe gjumi nuk të afrohet. Kur u gdhi, Tirana ishte në alarm. Maqinat venin e vinin dhe shërbëtorët e fashizmit, me çanta nën sqetull, të zverdhur nga frika, ktheheshin në shtëpitë e tyre. Alarm? 24 korriku shqetësoi maqinën fashiste jo vetëm në Shqipëri, po edhe jashtë kufive. Nga Athina, nëpërmjet radios, i dërgoheshin Musolinit në Romë telegrame: «Nga gjendja e telekomunikacionit me Shqipërinë, ne nuk e ndjejmë veten të sigurtë...»

Maqinat luftarake, të ngarkuara me ushtarë, tanket, motoçikletat dhe avionët e armikut qarullonin në të katër anët e Shqipërisë, po më kot. Nuk mund të ndalosh me zjarr e hekur hovin e një populli, që s'e ka pranuar kurrë robërinë.

Dhe telegramet nga Roma vinin të rrepta.

«Mbahuni, trimat e Imperos! Vrisni, digjni!»  
— porosiste Musolini.

Vojua u ngrit, lau sytë, veshi kostumin, vuri borsalinon, përkuli mbi ballë strehën dhe, me të rënë dielli, zbriti në qytet. Pranë çdo dere që kaloi dëgjoi se populli, të rinj e plëq, burra e gra, bisedonin për këtë aksion të madh që kishin kryer

komunistët kundër fashizmit. Edhe ai e ndjente veten krenar që kishte dhënë ndihmën e vet në këtë aksion të gëzuar për kombin.

Si bleu gazetat, mori rrugën e Dibrës për të takuar Tarasin. I dukej vetja më i fuqishëm. Ecte serbes dhe i gëzuar, se do t'i njoftonte Tarasit për aksionin e madh. U kthye në rrugicë, trokiti në derë dhe hyri te miku, me të cilin kish bashkuar fatin e tij.

Takimi i Vojos me Tarasin zgjati disa orë.

Edhe atë natë doli nga Tarasi më i pasur në shpirt. Kur i ke dalë për zot revolucionit, kujton se orë e çast jeton e punon vetëm për të dhe s'ke kohë për asgjë tjetër.

\* \* \*

Si çdo natë, qyteti u zbraz me të perënduar dielli. Në rrugicat, qytetarët shpejtonin hapin. Në turmën që ecte në mbrëmje rrugës së Shëngjergjit, ishte edhe Vojua. Pas dhe përpara tij ishin shokë me duar në xhepe. Atë natë do të krvenin një aksion.

Një nga një, të pesë shokët hynë në një shtëpi përdhese, zunë vend në dhomë dhe ndezën një kandil. Për të mos humbur kohë. Vojua shtroi përpara një hartë të vogël, ku ishte vizatuar aerodromi i Tiranës. Ai u shpiegoi shokëve me hollësi për pengesat që kish rreth e qark dhe si do të vepronin në çastin e fundit:

— Në çdo metër të telave, fashistët kanë vu zile dhe, po t'i luejsh pak telat, ato bajnë zhurmë. Prandaj do të mbushim xhepat me leckë e barë e do t'i shtupojmë mirë e mirë. Mandej do të pre-

sim telat e do të hapim shtegun drejt prozhektorit.

— Ta zemë se arritëm deri atje, — tha njëri nga shokët, — po si do ta thyejmë?

Vojua vuri dorën në brez.

— Ja kjo e ka fjalën. Do t'i biem shtatë herë me radhë dhe pastaj me njanën prej këtyne, — dhe tregoi një granatë të zezë kuti-kuti, si çokollatë.

Është vonë. Në rrugën e Kavajës dëgjohet vetëm zhurma e një automjeti, që rrëshqet drejt perëndimit. Më të rrallë pasqyra e madhe rrotullohet duke lëshuar një dritë të fuqishme.

Të pesë shokët, duke lënë pas krahëve rrugica e shtëpi, ju afruan telave me gjëmba që rrethonin gjithë fushën. Vojua, duke u tërhequr zvarë, arriti pranë tyre. Kapi ngadalë një zile, e shtupoi mirë e mirë me një sukull leckash, pastaj të dytën, të tretën... dhe futi gërshërën në tela: trak-trak-trak si të ishin fije peri, ato u këputën e shtegu u hap.

Nuk është e lehtë kjo punë. Të dridhet zemra kur kujton se në atë fushë ka gryka zjarri më shumë nga sa ka pylli, lisa, po guximi komunist nuk ka kufi.

Në horizont duken dy bajoneta. Dy roje ruajnë prozhektorin. Më tej, të tjerë venë e vinë fushës. Gjithë aerodromi ka roje. Në krye të shokëve, Vojua ecën këmbadoras, derisa afrohet fare pranë. Pastaj, si merr granatën e parë që i kishte dhënë Tarasi, e shtrëngon me dorën e diathtë e thërret:

— Hidhni armët! Dorëzohuni!

Dy rojet ua mbathën këmbëve, ndërsa granata e Vojos, pasi lëshoi një flakë verbonjëse, krisi



mu pranë xhamit të madh të prozhektorit, në mes të fushës. Copëzat e xhamit fluturuan në erë duke fishkëllyer. Më tej rënkoj një nga rojet.

— Detyra u krye, — tha Vojua. — Tani tërhiqemi. Mbroni shoku, shokun. Drejtimi: kodrat e Saukut.

Në fushë plasi pushka. Mitrалozët villnin zjarr në të katër anët. Po më kot: skuadra e trimave të kryeqytetit kishte dalë shëndosh e mirë jashtë rrezikut.

Që në pushkët e para u përhap lajmi se komunistët jetuakan në Tiranë dhe luftuakan si gjithnjë e se ata nuk qenkan zhdukur, po, përkundrazi. u shtuakan çdo ditë e më shumë.

Qielli dukej blu. Në të xixëllonin me mijra yje. Drita e tyre tani ishte e qartë: prozhektori nuk ua errësonte shkëlqimin.

Komandanti i aerodromit, mbyllur në një dhomë, njoftonte në telefon shefin e tij:

— ... Komunistët pushtuan aerodromin. Forcat që komandoj unë, u tërthoqën në strehime. Prozhektori është grabitur nga komunistët. Ndihmioni sa nuk është vonë.

— Qendroni edhe dy orë. Tanket muarën urdhër të sulmojnë në drejtimin nga kanë sulmuar komunistët...

Kur ra dielli, gjendja ishte normalizuar. Krismat pushuan. Komandanti i garnizonit, gjeneral Teraçini, inspektonte «sheshin e luftës». Ai pa tri zile, grykat e të cilave ishin shtupuar me leckë. një shteg të çelur përmes telave të prerë dhe verigën e një granade.

«Agresion i madh. Një kompani komunistësh sulmoi aerodromin. Pas gjashtë orësh luftimi, ata

asgjesuan prozhektorin e madh. Duam përforcime».  
— Gjeneral S. Teraçini.

Sekretari mbante shënim me të shpejtë. Pas tridhjetë minutash, këto rreshta kishin mbritur telegrafisht te Musolini. Telashe në lindje të Adriatikut. Populli lufton për liri. Ndërsa në një shtëpizë të Kodra e Kuqe, Vojua, me një grup shokësh, bisedonte për shtigjet e reja që do të çelnin për të goditur armikun sa më afër zemrës.

— U ndez flaka e lirisë, shokë, u ndez ashtu si t'ha Tarasi. S'do të ketë forcë të shuajë këtë hov revolucionar.

\* \* \*

Gjethet po binin. Vjeshta kishte pushtuar vendin. Në oborrin e shtëpisë kishte dy kajsi që kishin zbuluar krahët. Hardhia, si një tërkuzë, zgjatej deri në çati. Vjeshtë. Një vjeshtë e mërzitshme.

Edhe atë natë të tre shokët, si hëngrën darkë, u shtrinë në minderin e tyre. Herë-herë bënin ndonjë muhabet për jetën, luftën...

Sadik Stavaleci shpesh kollitej rëndë. Shaminë e vogël nuk e hiqte nga goja. Mendonte se mikrobet e tuberkulozit nuk do ta kalonin atë shami të mbushur me njolla gjaku. Në anën tjetër, përballë tij, Xhorxhi Martini po ndërronte plagën që kishte në këmbë. Një shok kishte sjellë disa fasha e një pluhur si pudër. Ndërsa Vojua, me atë trupin e tij të shëndoshë e të zhdërvjellët, ishte mbështetur brinjazi e po fshinte armën. Një copë herë heshtën. Pastaj Sadiku ju drejtua Vojos:

— Ma ndjen ky gjoks i coptuar se kjo natë do të jetë e kobshme, Tarzan!

— Mbase të duket ashtu ngaqë është e errët. Sadiku u kollit edhe një herë e vazhdoi:

— Ju keni fjetur pak në mbrëmje, kurse mua s'më ka zënë gjumi fare. Gjithë kohën, qëkurse është errur, janë rropatur udhët sonte. Sikur na kanë rënë në erë.

— Si çdo natë, fashistët kanë frikë nga hieja e vet, po, meqë janë shumë, venë e vinë e rrugët janë fry syresh. Mandej këtu i thonë Kodra e Kuqe. Dhe a e dini si ka mbetë ky emën? Vite më parë, këtu ka shkue gjaku deri në gju. Ja, diku në themelet e këtyne shtëpive ishte një lis, nën hijen e të cilit kalojshin vapën çobania. Beu i fushës së Tiranës u erdhi një ditë e, me shkop në dorë, desh t'i përzinte. Plasi pushka e u vranë nga të dy anët, sa shkoi gjaku rrëke; dhe qysh atëhere ky vend asht quejt Kodra e Kuqe. Me sa duket, na kena me e skuqë edhe ma shumë me gjak komunisti.

— Po të jetë nevoja, do ta skuqim... (kolla e ndëpreu për një çast). Kam dëshirë që ky gjoks, në të cilin rreh kjo zemër, më mirë të shpohet nga plumbat, se sa ta brejë sëmundja... — dhe përsëri u kollit.

— Do të bahesh ma mirë, Sadik. Mbaje vedin. Ke me pa...

— Po, besa, — ndërhyri Xhorxhi, — mirë thotë Vojua. Do të bëhesh më mirë. Që në fytyrë kuptohesh se ke ndryshuar. Pastaj ditët e fitores nuk janë larg. Ushtria e Kuqe, me Stalinin në krye, po i dërmon hitlerianët. Në të gjitha vendet është ndezur një luftë partizane, sa nuk i jep kohë Hitlerit të marrë frymë.

Sadiku bëri buzën në gaz.

— Në iemi komunistë dhe komunistët nuk kënaqen me lugë të zbrazur. Mbajeni mend, shokë, unë prej kësaj sëmundjeje nuk shpëtoj. Veçse dëshira që më vlon këtu, në gjoks, është të vdes atje ku thotë partia jonë, sepse vetëm kështu gjaku nuk do të rrjedhë kot. Duke vdekur në krye të detyrës, edhe pse e kam gjoksin të coptuar, ngre lart partinë tonë. Ja, këtu kam një gazetë të «nderuar» — «Fashizmi». Shikojeni çfarë kanë shkruar me gërma të mëdha: «Fara e komunizmit nuk do të mbijë në Shqipëri». Duket që na e kanë frikën, prandaj bëjnë sikur s'na shohin e s'na ndjejnë.

— Atëhere pse sillen gjithë natën si zagare udhëve? Folë! Ata nuk e ndjejnë veten të sigurtë. Kur bien të flenë, u duket sikur komunistët janë duke u vënë minat nën krevat. Prefekti po marrëset fare. Ka vënë roje edhe në derën e dhomës së fjetjes, madje i paguan një rrogë nga arka e shtetit dhe një rrogë personale. E pra, pse shqetësohen kur qenka kështu?..

Xhorxh Martini qeshi. Pastaj u ngrit. Mori një libër nga rafti e nisi të lexojë, kurse Vojua doli në sallon. Dritarja ishte e hapur. Dukej edhe rrugica. Rrëzë mureve ai pa se si ishin mbështetur njëri pas tjetrit skuadra të tëra milicësh me helmeta në kokë. U afrua te këndi i dritares dhe u përpoq të dallonte se çfarë kish përtej shtëpisë. Ishte e qartë: rrethimi ishte kryer. Si hije të zeza kalonin njëri pas tjetrit milicë e xhandarë. Këpucët kërcisnin mbi gurët e rrugicës. Siç dukej, Kodra e Kuqe përsëri do të skuqej me gjak. «Qenkemi të rrethuem», — mendoi Vojua. Ai nuk e prishi qetësinë, po i shkoi mëndja te Xhorxhi i

plagosur, te Sadiku, gjoksi i të cilit ishte i cop-tuar. Nuk ishin mirë nga shëndeti dhe për këtë Vojua e ndjente përgjegjësinë. Në këto mendime e sipër u kthye në dhomë. Dhe, ndonëse koha s'priste, ai ngurronte t'u jepte shokëve lajmin e hidhur. U ul pranë Sadikut dhe, me dorën e tij të gjerë, i preku gjoksin:

— Edhe na thua se je i sëmundë. Ti ma ke gjoksin si granit. Qofsha unë kështu si ti.

Sadiku ktheu kokën nga shoku, e pa drejt e në sy, vuri buzën në gaz e tha:

— Eh, Vojo, Vojo! Unë e di, e ndjej... se në këto çaste të vështira nuk na ka hije ne, komunistëve, të themi se jemi të sëmurë. Po ti, pse je shqetësuar? Unë të kuptoj që në fytyrë.

Vojua u ul në minder, fërkoj duart e tha:

— Shokë, në rast se na kanë rrethue, a jeni në gjendje të çajmë përpara?

Dorën e kishte shtrirë, sikur do të tregonte nga shkohet përpara. Edhe Xhorxhi u ngrit ndenjnas. Vuri librin në prehër dhe u kthye nga Vojua:

— Ne edhe të vdekur do të marshojmë vetëm përpara!

— Ju lumtë, shokë. Nuk due me ju fshehë asgja: na jena të rrethuem! Po më ndigjoni mirë: unë nuk dorëzohem i gjallë, porse ju... jeni të sëmundë, prandaj, po të doni, ju qes... dhe...

Sadiku u kollit edhe një herë e, si mori frymë, ju drejtua Vojos:

— Vojo, ne ja kemi dhënë fjalën partisë, bashkë do të vdesim të gjithë këtu, në Kodrën e Kuqe.

Vojua e përqafoi shokun. Edhe xhorxhi e palosi librin «Nëna» dhe ju afrua Vojos.

— Ajo që kishte me ndodhë nesër, ndodhi sot,  
— vazhdoi Vojua. — Kjo asht kulla e partisë e, pa  
vajt gjaku deri në gju, nuk do të dorëzohemi.  
Rrokni armët, shokë, e zeni vendet pas dritareve.

Përjashta mbretëron një heshtje e rëndë. Një  
erë e lehtë fryn dhe përplas mbi dritare gjethet e  
fundit të pemëve që rrethojnë shtëpinë. Qielli është  
i kthjellët. Rruga është mbushur plot. Po vallë,  
çfarë presin? Përse nuk fillojnë? Ndofta sepse e  
dinë që nuk është e lehtë të luftosh kundër komunis-  
tëve!

Sa të gjata duken minutat para fillimit të  
betejës. Të duket se nga çasti në çast diçka do të të  
përpijë.

Qetësinë e prish vetëm kolla e Sadik Stavale-  
cit, e cila ndihet deri në rrugicë.

Kalon një orë shqetësuese, dy... Sahati i Tira-  
nës ra dymbëdhjetë herë. Dy ditë ndahen njera  
nga tjetra. Nis një ditë e re: dhjetë tetor.

Në derë trokasin me të fortë. Taktaket e saj  
paralajmëronin fillimin e betejës në Kodrën e Kuqe.

— Hapeni!

— Kush po më prish qetësinë në këtë orë?

— pyeti Vojua si pa të keq me zërin e tij të  
trashë.

— Kontrolli!

— Në mëngjez urdhëroni. Tash nuk po e çilim  
derën. Na leni të flejmë.

— Hapeni me të mirë, se do ta thyejmë.

— Atëhere çka prisni? Urdhëroni!

— Hapeni me të mirë, ju themi, për të fundit  
herë. Shtëpia është e rrethuar.

— Jo nuk e çilim derën, pa çilë synin dielli.  
Ju baj thirrje të mos na prishni qetësinë. Kjo

asht lagje punëtores, njerëzit janë të lodhur dhe kështu nuk asht mirë.

— Jini të rrethuar. Hapeni.

Vojua u kthye te shokët pa e prishur fare qetësinë, si të mos kishte ndodhur asgjë. Ndonëse nga jashtë dëgjoheshin britmat, ai nuk përgjigjej më. Nga dritarja e shtëpisë tjetër përsëri dikush po thërriste:

— Dëgjoni! Jini të rrethuar! Hidhni armët dhe dorëzohuni! Nëqoftëse nuk do të bëni qëndresë, do të faleni, do të shkoni pranë shtëpive tuaja, pranë prindve...

Xhorxhit i hipi gjaku në kokë. Hapi me të shpejtë dritaren.

— Kjo është shtëpia jonë! Nuk dorëzohemi! Ne ju bëjmë thirrje të lironi udhën e të mos dëmtoheni. Ju jini gjak shqiptari dhe nuk është mirë të vriteni këtu. Ne nuk jemi të vetëm. Ne jemi komunistë...

Fjala «komunistë» gjëmoi si krismë topi në veshët e fashistëve. Kujt nuk ju drodh zemra nga frika? Ata e kishin provuar sa herë se ç'do të thotë komunist. Komandanti nuk priti më: dha urdhër:

— Zjarr!

Flaka çau errësirën dhe predhat thyen xhamet e shtëpisë. Lufta filloi flakë për flakë. Plumbat përshkonin kryqas e tërthor mbi shtëpitë e lagjes. Tirana gjëmoi.

Vojua hodhi në rrugicë granatën e parë që përfshiu tre milicë. Pastaj, me zërin e tij të fuqishëm, thërriti:

— Përpara, shokë! Rroftë Partia!

Dritare më dritare, jo si të ishin tre, po tre-

qind, zjarr për zjarr me armikun, ata tregonin se komunistët dinë të vdesin.

Orët kalonin. Yjet nisën të rrallohen. Agoi. Po Kodra e Kuqe, si një kështjellë legjendare, qendronte. Tani vendi dukej mirë. Syrit të tre sokolëve nuk i shpëtoje dot. Sa herë qëllonin, palosnin nga një këlysh. Rrugica rrëzë shtëpisë u lirua. Armiqtë kaluan në rrugën tjetër. Tirana ishte në alarm. Nga të gjitha anët vinin forca të reja, sikur donin të shuanin një vullkan të madh në shpërthim. Bombat binin rreth e qark shtëpisë. Nuk qendrohej më. Duhej dalë me gjoks përpara. Duhej çarë rrethimi.

Edhe një bisedë e shkurtër në afë shtëpi-kështjellë dhe vendimi u muar: të tre sokolët do të çanin rrethimin drejt veriut. Sadik Stavaleci, me pushkën në dorë, zbret shkallët shpejt, çel derën e avllisë e thërret:

— Përpara, shokë!

Të duket se nuk e merr plumbi. Kundërshtari dridhet.

Si hodhën tri granata njëherësh, vendin e mbuloi tymi. Dolën në rrugicë, po nga shtëpia e lartë në anën e poshtme dy gryka zjarri prisnin në heshtje. Ato lëshuan breshëritë e para. Gjoksi i Sadikut u bë shoshë. Megjithëkëtë, trimi u kthye përsëri në derë. Vojua i shtiu krahët dhe, përmes plumbave, e ktheu në dhomë.

— Sadik, Sadik...

Po Sadikun e kishin lënë forcat. Ai me zor i hapi sytë dhe, si nëpër mjegull, pa Vojon që i rrinte te koka. Ashtu nëpër buzët e gjakosura, mezi bëlbëzoi: «Lamtumirë!» dhe ra në krahët e shokut.

Vojua e uli ngadalë, sikur donte të mos i



lëndonte gjoksin e coptuar nga plumbat. E mbësh-teti në minder ngadalë, u përkul dhe e përqafoi heroin. Veshët i ushtonin dhe dëshira për shpagë e bëri të papërmbajtur. Nuk ka hidhërim më të madh se kur humbet shokun, atë me të cilin ke lidhur besën për t'ja arritur qëllimit, atë me të cilin ke ndarë hidhërimet e gëzime.

Ja hoqi ngadalë granatat nga mesi, i futi nëpër xhepat e veta dhe nisi të dalë, po në çast në derë u duk Xhorxhi. Edhe gjoksi i tij ishte bërë shoshë. Fytyra i ishte larë me gjak dhe, si një lis i goditur nga rrufeja, edhe ai ra në këmbët e Vojos.

— Lamtumirë, Tarzan! Rroftë Partia!

E mori në krahë dhe e afroi pranë Sadikut. I ngjante sikur po flinin pranë njëri tjetrit. Nën minder ishin fashat e plagës së Xhorxhit dhe, pak më tej, libri, që plumbat e kishin hedhur në tokë. E mori ngadalë dhe ja afroi te koka.

— Tani po ndahemi përnjimend. Më erdhi mue radha, shokë. Ja, dëgjoni. Dhe thërriti: «Përpara, shokë!»

Hodhi granatën dhe kërceu nga dritarja. Kaloi avllinë e shtëpisë së parë, të së dytës dhe, nëpërmjet një kopshti kaloi në rrugicën tjetër. Ndërsa ecte me vrap, mendjen e kishte te shokët, sikur me ta kishte lënë zemrën e tij.

U ngjiti në një mur që të dilte pas krahëve të armikut, po në çast përpara tij u duk tanku, i cili kishte rrëzuar muret e avllisë dhe ecte drejt shtëpisë ku ishte më parë Vojua.

Vojua e mblodhi veten, u kthye prapa, hapi derën e një shtëpie dhe hyri brenda. Në dhomë ishte varur një automatik italian. Sytë i shkrepëtinë. Ai s'kishte asnjë armë dhe ja, për fatin e

tij, tani u bë me automatik. E rrëmbeu dhe përsëri u ngjit te muri i avllisë. Sa mendime i erdhën në atë çast! Çasti i fundit gjithmonë të kujton shumë gjëra. Përpara syve i dolën Xhorxhi, Sadiku... I dukej sikur dëgjonte zërin e Tarasit, i cili, rreth tryezës, u kishte thënë: «Liria i ka rrënjët në gjak».

Po në rrugicë ka zhurmë. Zinxhirët e tankut kërcasin. Pas krahëve ndihet gjëmimi i bombave.

Ai u hodh me guxim në sulm mbi tankun e armikut.

— Përpara, përpara! — këto fjalë i buçitnin në shpirt. Dhe ja...vegim:

...Zëri buçet, jehon gjer tej në male. Kulla e çeliktë, mbi të cilën ai u hodh që ta drejtonte vetë, ecën përpara. Skuadrat, togat dhe kompanitë fashiste ngrenë duart lart. Kurrë nuk kishin parë guxim të tillë. Vojua vazhdon përpara, can rrethimin. Pas pak ndalon te porta e një shtëpie në të ngjitur të Kodrës së Kuqe. Aty flenë Xhorxhi me Sadikun. Do t'i zgjojë.

— Çohuni, shokë! Mjaft keni fjetë!

Një dritare hapet. Sadiku, me shaminë përpara gojës e me një flamur mbi një shtizë në dorën e majtë, kollitet e përshëndet. Flamuri i kuq valvitet. Pas pak shikon edhe Xhorxhin. Ai ka vënë librin nën sjetull dhe duartroket.

— Liri! Liri!

— Liri! Liri! — përgjigjet edhe vetë Vojua dhe e shkel gazin më fort.

Kulla e çeliktë, me zinxhirët e saj, rrëshqet nëpër rrugicë. Pas pak në sheshin e gjerë, populli, me lule në duar, pret çlirimtarët. Të gjithë brohorasin. Sheshi i gjërë mbushet me lule.

Ai ecën tërë krenari. Ja edhe Tarasi, me trupin e hedhur dhe i veshur me uniformën e gjeneralit, i rrethuar nga shokët, i drejtohet atij dhe e përshëndet.

— Hajde, Vojo. Të prisnim. Të pret populli... Përqafohen.

— Liri!...

Por ëndrra ndërpritet.

Fërkon sytë. Përpara përsëri i duket tanku. I vlon e njëjta dëshirë: të hapë kapakun e të hyjë brenda. Lëshon automatikun nën dorë dhe, duke mos përfillur rrezikun, hidhet. Pastaj, me guxim, përkulet të hapë kullën e hekurt, po... nga prapa krahëve vjen tanku tjetër, vinë predhat. Një breshëri dhe shpatullat i coptohen. Automatiku i bie nga dora, gjunjët i priten dhe drita i venitet. Po nuk rrëzohet në tokë: të duket sikur ulet për t'u çlodhur mbi kullën e hekurt e mbi të mbaron. Gjaku i tij rrjedh anëve të hekurit të gjelbër, sikur do ta skuqë edhe atë, për ta kthyer në një Kodër të Kuqe, kodër të flamurit të kuq që kishte shpallur Arbëria, kodër ku u shkrua edhe një faqe e lavdishme e marshimit të madh.

Tirazhi 6000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

---

Shtyp NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»  
Stabilimenti «8 Nëndori» — Tiranë, 1968